

Ju kanë vjedhur kartën e kreditit apo të dhënat bankare?



Çdo ditë, gjithnjë e më shumë njerëz po shijojnë përvojën e blerjeve në internet. Kujdes! Tregohuni të kujdesshëm sepse mashtruesit janë gjithmonë në kërkim të mënyrave për të vjedhur të dhënat bankare!

Ata përdorin faqe interneti të rreme dhe gjithashtu mund të dërgojnë emailë mashtruese (phishing) duke pretenduar se janë nga faqe të njohura.


Çfarë duhet të bëni?

Nëse llogaria juaj bankare është komprometuar ose vëreni një aktivitet të pazakontë, këtu janë disa hapa që mund të ndërmerri:

1. Kontaktoni menjëherë institucionin tuaj financiar për të bllokuar kartën tuaj. Ju mund të jeni në gjendje t'i kërkoni paratë tuaja dhe të parandaloni vjedhjen e mëtejshme.




3. Përditësoni programin tuaj anti-virus për të luftuar viruset e reja dhe për të mbrojtur pajisjen tuaj.



63%

4. Raportoni. Informacioni juaj mund të ndihmojë në kapjen e mashtruesit dhe në parandalimin e incidenteve të mëtejshme.



2. Ndryshoni fjalëkalimet tuaja. Krijoni një fjalëkalim të ri të fortë me të paktën 15 karaktere, duke përfshirë shkronja të mëdha dhe të vogla, numra dhe simbole.

Një *passphrase* mund të jetë më e lehtë për t'u mbajtur mend. Kjo mund të jetë një fjali që përfshin fjalë të pazakonta ose fjalë nga gjuhë të ndryshme.

Ju gjithashtu duhet të ndryshoni *detalet e login* për ndonjë nga llogaritë tuaja të tjera që përdorin të njëjtin ose të ngjashëm emër përdoruesi dhe fjalëkalimi.



5. Sigurohuni që të mbani çdo dëshmi që keni për vjedhjen, si për shembull: email, fatura etj.



6. Ndani përvojën tuaj me familjen dhe miqtë për t'i mbrojtur ata.

